



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 6 paragrafi 6.3 bie këtë:

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “AL-BER” SH.P.K. e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 02.11.2020 për aktivitetin e prokurimit me numër 626-20-5348-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-20-026-5-2-1 me titull “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në Mamushë-Faza e parë, ndërtimi i vrazhdët”

II

Vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 27.10.2020 me të cilin është shpërblyer me kontratë Grupi i operatorëve ekonomik AAB CONSTRUCTION " SH.P.K. N.P.SH “BAGERI” & “AL-GROUP” SH.P.K. – Prishtinë

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “AL-BER” SH.P.K. me datë 02.11.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në Mamushë-Faza e parë, ndërtimi i vrazhdët”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 7 dhe 59 të LPP-s si dhe neneve 3 dhe 41 të RRUOP . Në bazë të vlerësimit tonë, të gjitha këto pretendime të shkeljes së legjislacionit të prokurimit publik janë të pa baza.

Sa i përket pretendimit të parë të O.E. ankues se grupi i O.E. nuk e ka plotësuar si duhet formularin e dorëzimit të tenderit, konsiderojmë se është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazë. Në dosje të tenderit në nenin 11.1 është paraparë se si duhet të jetë forma e grupit. Grupi i O.E. i rekomanduar me tenderin e tyre i ka dorëzuar marrëveshjet e grupit për tenderin në fjalë. Gjithashtu të gjithë anëtarët e grupit

kanë qenë të regjistruar në platformën elektronike të KRPP-së andaj ne kemi llogaritur se e ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Edhe pretendimi i dytë se O.E. i rekomanduar nuk i ka paraqitur ndryshimet në platformën elektronike është i pa bazuar, pasi që ne kemi kërkuar që O.E. të jetë i regjistruar në platformën elektronike si dhe të paraqesë dokumentet e caktuara. O.E. i rekomanduar në momentit e dorëzimit të tenderit ka qenë i regjistruar dhe ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar. Është çështje e bizneseve për ti përditësuar të dhënat apo për ndryshime të emrit dhe jo çështje e jona si Autoritet Kontraktues.

Vlerësimi i tenderit në fjalë është bërë në përshtatje me dispozitat e LPP-s dhe kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Grupi i O.E. AAB CONSTRUCTION " SH.P.K. N.P.SH "BAGERI" & "AL-GROUP" SH.P.K. – Prishtinë i ka plotësuar të gjitha këto kërkesa andaj me të drejtë komisioni i vlerësimit, tenderin e tyre e ka cilësuar si tenderin e përgjegjshëm. Pra në bazë të asaj që e cekëm më lartë, pretendimi i O.E. se janë shkelur dispozitat e nenit 59 të LPP-s dhe nenit 41 të RROUP-s është i pa bazë.

Ne si Autoritet Kontraktues, i kemi trajtuar të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi apo favorizimi. Për dokumentet të cilat na ka lejuar legjislacioni i prokurimit, gjatë vlerësimit të tenderit kemi kërkuar sqarimet e nevojshme nga grupi i O.E. fitues si dhe nga O.E. tjerë pjesëmarrës, andaj konsiderojmë që kemi bërë një vlerësim të drejtë, profesional dhe të pa anshëm.

Sa i përket dëmeve materiale, në dosje të tenderit është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. Andaj edhe ky pretendim është i pa bazë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 09.11.2020

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.